



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 55, DATË 05.08.2020

PËR

HEQJEN E LICENCËS SË SHOQËRISË “RTV-REAL” SH.P.K., PËR
SUBJEKTIN AUDIOVIZIV PRIVAT “TV RE.AL”

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve:

Kërkues: AMA kryesisht,

Objekt: Heqja e licencës së shoqërisë “RTV-RE.AL” sh.p.k., për subjektin audioviziv “Tv Re.AL”

Baza Ligjore: Nenet 19, pika 16 dhe 69, pika 3 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

VËREN SE:

Shoqëria “RTV-REAL” sh.p.k., është licencuar nga këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (sot Autoriteti i Mediave Audiovizive) me vendimin nr. 194, datë 12.11.2010, për subjektin audioviziv privat vendor “TV RE.AL”, për të ushtruar veprimtari audiovizive në qytetin Vlorë. Pas përfundimit të afatit të vlefshëmrisë së licencës AMA, me vendimin nr. 254, datë 21.12.2016, ka vendosur zëvendësimin dhe rinovimin e licencës deri në mbylljen e transmetimeve analoge.

AMA konstaton se shoqëria “RTV-REAL” sh.p.k., është debitor ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit, pasi nuk ka shlyer detyrimet financiare pagesë vjetore për licencë për vitin 2019. Në këto kushte, gjatë vitit 2019, ka njoftuar shoqërinë “RTV-REAL” sh.p.k., licencuar për shërbimin e programit audioviziv “TV RE.AL”, mbi detyrimet financiare duke kërkuar shlyerjen e tyre.

Pavarësisht komunikimeve të përsëritura, subjekti vijon të jetë debitor ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit, në masën 119,320 lekë, prej të cilave:

- 71,320 lekë për pagesë vjetore për licencë dhe
- 48,000 lekë për tarifë për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive.

Po ashtu, në zbatim të vendimit të AMA-s nr. 220, datë 01.12.2017 “Mbi përcaktimin e pagesave për licencë/autorizim dhe shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive”, ndaj subjektit ka filluar përlllogaritja e kamatëvonesave prej datave 01.04.2019, 01.11.2019 dhe 01.12.2019. Në këto kushte, vlerës së mësipërme të pagesës vjetore për licencë i shtohet edhe vlera e kamatëvonesës, në masën 14,026 lekë, e llogaritur deri më datë 31 dhjetor 2019.

Duke qenë se nga ana e subjektit nuk u morën masat për shlyerjen e plotë të detyrimeve financiare pavarësisht njoftimeve të përsëritura gjatë vitit 2019, AMA me shkresën nr. 4495 prot, datë 19.12.2019, njoftoi subjektin për fillimin e procedimit administrativ për heqjen e licencës së shoqërisë “RTV-REAL” sh.p.k., për subjektin audioviziv privat “TV RE.AL”.

Subjektit, me shkresën nr. 68 prot., datë 09.01.2020, i është bërë me dije se shqyrtimi administrativ për heqjen e licencës të shoqërisë “RTV-RE.AL” sh.p.k., licencuar për subjektin audioviziv privat “TV RE.AL” do të bëhej në mbledhjen e radhës së AMA-s. AMA, në mbledhjen e zhvilluar në datën 16.01.2020, mori në shqyrtim çështjen e vlefshmërisë së licencës së subjektit, për shkak të mosshlyerjes së detyrimeve financiare ndaj AMA-s. Në përfundim, AMA ra dakord t’i caktojë subjektin datën 29 janar 2020, si afat të fundit për shlyerjen e plotë të detyrimit financiar.

Më tej, AMA në mbledhjet e datave 29 janar 2020 dhe 20 shkurt 2020, pasi mori në shqyrtim çështjen e vlefshmërisë së licencës së subjektit, ra dakord që shoqërisë “RTV RE.AL” sh.p.k. t’i caktohej edhe një afat tjetër, për të shlyer detyrimet financiare ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit për vitin 2019.

Në vijim, AMA rimori në shqyrtim këtë procedim administrativ në mbledhjen e datës 29 maj 2020, duke qenë se subjekti vijonte me statusin e debitorit ndaj autoritetit dhe Buxhetit të Shtetit, por për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm ligjor prej 5 votash, nuk u miratua vendimi për heqjen e licencës vendimmarrja është shtyrë.

Edhe në mbledhjen e AMA-s, së datës 18 qershor 2020 u shqyrtuar kjo çështje, por vendimmarrja është shtyrë sërish.

Pavarësisht, njoftimeve të përsëritura nga ana e AMA-s subjekti vijon të jetë debitor ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit në masën 133,346 lekë për vitin 2019, prej të cilave 71,320 lekë për pagesë vjetore për licencë; 48,000 lekë për tarifë për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive dhe 14,026 lekë kamatëvonesa për vitin 2019.

Në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 69, pika 3, parashikohet se:

“AMA ka të drejtë të heqë licencën dhe/ose autorizimin kur: ...

3. Nuk paguan detyrimet financiare të licencës për një vit....”

AMA vëren se pavarësisht se subjektit i është lënë kohë për shlyerjen e detyrimeve financiare ndaj autoritetit, nga ana e tij nuk është respektuar afati për shlyerjen e detyrimeve financiare, duke mbetur debitor ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit,

PËR KËTO ARSYE

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në mbështetje të nenit 19, pika 16 dhe nenit 69, pika 3 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Heqjen e licencës së shoqërisë “RTV-REAL” sh.p.k., për subjektin audioviziv “Tv Re.AL”, për shkak të mosshlyerjes së detyrimeve financiare për një vit.
2. Shoqëria “RTV-RE.AL” sh.p.k., është debitore ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit për vitin 2019 në masën në masën 133,346 lekë.
3. Të kryhet rillogaritja e detyrimeve financiare ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit për vitin 2020.
4. Shoqëria “RTV-RE.AL” sh.p.k., me njoftimin e këtij vendimi, ka detyrimin ligjor të ndërpresë menjëherë transmetimin.
5. Ngarkohet administrata e AMA-s për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Gentian

SALA

Zëvendëskryetar:

Sami

NEZAJ

Anëtarë:

Agron

GJEKMARKAJ

Gledis

GJIPALI

Suela

MUSTA